

Njoftim për privatësi për fushatën e
lojës shpërblyese "#ProVozitu me
ProCredit Bank dhe Mastercard"

Ky njoftim për privatësi shpjegon se si ne, ProCredit Bank SHA Shkup, i mbledhim, përdorim, përpunojmë, ndajmë dhe i mbrojmë informacionet që kanë të bëjnë me fushatën tonë të lojës shpërblyese "#ProVozitu me ProCredit Banka dhe Mastercard". Me pëlqimin e dhënë për të marrë pjesë në fushatën tonë të lojës shpërblyese, ju pajtoheni me mbledhjen dhe përdorimin e informacioneve tuaja personal siç përshkruhet në këtë Njoftim për privatësi.

Informacionet që i mbledhim

Ne mund të mbledhim llojet e mëposhtme të informacioneve nga ju, kur merrni pjesë në fushatën tonë të lojës shpërblyese:

Informacioni i Kontaktit: Mund të mbledhim informacione për emrin tuaj, adresën e e-mailit dhe detaje të tjera kontakti që do të na i jepni ju.

Informacionet për pjesëmarrje: Ne mund të mbledhim informacione për pjesëmarrjen tuaj në fushatën e lojës shpërblyese, të tilla si pëlqimi juaj për të marrë pjesë, mosha, si dhe informacione në lidhje me llogarinë tuaj të pagesës, kartën e debitit të lidhur me llogarinë e pagesës dhe informacion në lidhje me transaksionet e kryera me kartën tuaj të debitit, në mënyrë që të konfirmoni se i plotësoni kushtet për të marrë pjesë në lojë shpërblyese.

Përdorimi i informacioneve

Informacionet që i mbledhim nga ju, mund ti përdorim për qëllimet e mëposhtme:

- Për realizimin e fushatës për lojën shpërblyese: Mund t'i përdorim informacionet tuaja për të verifikuar se mund të kualifikoheni për të marrë pjesë në fushatë, për t'ju kontaktuar në lidhje me pjesëmarrjen dhe për të dhënë shpërblimet. Për të komunikuar me ju: Ne mund të përdorim informacionin tuaj për t'ju dërguar përditësime dhe njoftime në lidhje me fushatën tonë të lojës shpërblyese dhe promovime të tjera, si dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja.

Ndarja e informacioneve

Ne mund të ndajmë informacionet tuaja me palët e treta në vijim:

- Ofruesit e shërbimeve: Mund t'i ndajmë informacionet tuaja me ofruesit e shërbimeve që na ndihmojnë në menaxhimin e fushatës sonë për lojën shpërblyese, të tilla si ofruesit e shërbimeve të postës elektronike dhe kompanitë e lojës shpërblyese.
- Kërkesat ligjore: Informacionet tuaja mund t'i ndajmë për të përmbushur detyrimet ligjore, të tilla si përgjigjja ndaj një thirrjeje ose urdhri të gjykatës.

Publikimi i informacioneve në mediat sociale dhe faqen e internetit

Nëse jeni fituesi i lojës tonë shpërblyese, mund të ndajmë informacionet tuaja personal (si emri dhe/ose emri i përdoruesit në mediat sociale) në kanalet tona në mediat sociale dhe ueb faqen <https://www.pcb.mk> me qëllim të shpalljes së fituesit. Duke e dhënë pëlqimin tuaj për këtë

njoftim privatësie, ju e kuptoni se të dhënat tuaja personale mund të jenë të dukshme për një audiencë më të gjerë dhe mund të përdoren edhe më tej nga të tjerë. Ne do të marrim hapa të arsyeshëm për të siguruar që informacioni juaj personal përdoret dhe zbulohet në përputhje me këtë njoftim privatësie dhe ligjet në fuqi.

Ju keni të drejtë të tërhiqni pëlqimin tuaj në çdo kohë duke na kontaktuar në mkd.dataprotection@procredit-group.com. Megjithatë, tërheqja e pëlqimit tuaj mund t'ju pengojë të merrni pjesë në fushatën për lojën shpërblyese.

Mbrojtja e informacioneve

Ne i ndërmarrim masat e nevojshme teknike dhe të sigurisë për të mbrojtur informacionet tuaja nga aksesit, përdorimi ose zbulimi i paautorizuar. Nëse ndodh që të ketë akses të paautorizuar deri te informacionet me fajin e subjektit të të dhënave personale, përgjegjësia për aksesin e tillë bie mbi subjektin e të dhënave personale.

Të drejtat tuaja

Ju keni të drejtë për akses të të dhënave tuaja personale që ne i ruajmë dhe t'i korrighoni. Gjithashtu mund të kërkoni që t'i fshijmë të dhënat tuaja personale nga të dhënat tona. Gjithashtu, nëse dyshoni se informacioni juaj po përpunohet ndryshe nga kjo që u tha më sipër në këtë Njoftim, ju keni të drejtë të kundërshtoni.

Më shumë informacione për mënyrën se si ProCredit Bank SHA Shkup i përpunon të dhënat tuaja personale dhe për të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave personale mund të gjeni në [Deklarata e privatësisë e ProCredit Bank \(Изјавата за приватносна Прокредит Банка\)](#).

Për të ushtruar këto të drejta, ju lutemi na kontaktoni në mkd.dataprotection@procredit-group.com

Nëse vlerësoni se përgjigja nuk është e kënaqshme ose keni pyetje të tjera, mund të kontaktoni edhe në Agjensinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Agjensia mund të kontaktohet në ++ 389 (2) 3230 635; ++ 389 (2) 3230 617 ++ 389 (2) 3230 790; ++ 389 (2) 3230 413; email: po@rshasu.tk. Adresa e Agjensisë është në katin e 14-të, Bulevardi Goce Dellçev 18, Shkup 1000.

Ndryshime në këtë Njoftim të Privatësisë

Herë pas here, ne mund ta përditësojmë këtë Njoftim të Privatësisë. Do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim duke i publikuar në Njoftimin e ri të privatësisë në faqen tonë të internetit. Ne ju rekomandojmë që këtë Njoftim të Privatësisë ta rishikoni periodikisht për ndonjë ndryshim.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë Njoftim të Privatësisë ose fushatën tonë të lojës shpërblyese, ju lutemi na kontaktoni në mkd.info@procredit-group.mk.

Faleminderit për pjesëmarrjen në fushatën tonë për lojën shpërblyese!

Përditësimi i fundit është bërë më 17.05.2023